

**INSITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDRDEVE**

**LËNDA: EDUKATË QYTETARE**

**(Klasa e pestë)**

**VITI SHKOLLOR 2008-2009**

**TIRANË 2007**

## TË PËRGJITHSHME

Edukimi qytetar demokratik bazohet në parimet themelore të të drejtave të njeriut, të demokracisë pluraliste dhe shtetit të së drejtës. Ai lidhet, para së gjithash, me të drejtat dhe përgjegjësitë, fuqizimin qytetar, pjesëmarrjen dhe përkatësinë, respektin për diversitetin. Si i tillë ai përfshin të gjitha grupet shoqërore dhe sektorët e shoqërisë.

Qytetaria demokratike bazohet në një metodë shumëpërmasore, që ka në bazë procesin dhe përfshin:

- ⊕ **Përmasën politike**, pjesëmarrja në procesin e marrjes së vendimit dhe në ushtrimin e pushtetit politik;
- ⊕ **Përmasën ligjore**, vetëdija dhe ushtrimi i të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve;
- ⊕ **Përmasën kulturore**, respekti për të gjithë njerëzit, vlerat themelore demokratike, për historinë dhe trashëgiminë e përbashkët dhe njëkohësisht të ndryshme, si dhe ndihma për vendosjen e marrëdhënieve ndërkulturore paqësore;
- ⊕ **Përmasën shoqërore dhe ekonomike**, veçanërisht përpjekjet kundër varfërisë dhe përjashtimit social, përpjekjet për krijimin e formave të reja të punës dhe të zhvillimit të komuniteteve dhe si ekonomia të mund të ndihmojë krijimin e një shoqërie demokratike;
- ⊕ **Përmasa evropiane**, vetëdija për unitetin dhe diversitetin e kulturës evropiane dhe të mësuarit për të jetuar në një kontekst evropian;
- ⊕ **Përmasën globale**, njohja, pranimi dhe nxitja e ndërvarësisë dhe të solidaritetit global.

### Synime

Edukimi për qytetari demokratike **synon**:

- ⊕ të përgatisë të rinjtë dhe të rriturit për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, duke fuqizuar kështu kulturën demokratike;
- ⊕ të aftësojë të rinjtë në luftën kundër ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës;
- ⊕ të sigurojë dhe të forcojë kohezionin shoqëror, drejtësinë sociale dhe në të mirën e përgjithshme;
- ⊕ të fuqizojë shoqërinë civile përmes pajisjes së qytetarëve me njohuri dhe shprehje demokratike;

Mbështetur në këto qëllime të përgjithshme, **lënda e edukatës qytetare në përgjithësi synon**:

- ⊕ *T'u japë nxënësve njohuritë dhe t'u zhvillojë aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe mënyrat e zbatimit të tyre.*
- ⊕ *Të zhvillojë aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësve dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.*
- ⊕ *Të zhvillojë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.*

## **Disa nga konceptet dhe aftësitë bazë të edukimit qytetar demokratik**

Edukimi qytetar demokratik përmbledh në vetvete një tërësi konceptesh ose vlerash themelore që janë të përbashkëta për të gjithë demokracitë moderne. Të kuptuarit ashtu siç duhet i këtyre koncepteve dhe vlerave dhe i marrëdhënieve të tyre në kushtet e ndryshimeve të shpejta, si dhe i rreziqeve që bartin, është kushti paraprak për një pjesëmarrje të efektshme dhe të përgjegjshme të qytetarëve në procesin e rindërtimit demokratik. Ja disa nga këto koncepte:

- *të drejtat e njeriut dhe liritë themelore* (univesaliteti, karakteri i pandashëm dhe i patjetërsueshëm i të drejtave dhe lirive, i standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut; legjislacioni ndërkombëtar i të drejtave të njeriut; të drejtat e trashëguara; institucionet dhe procedurat për zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut);
- *demokracia* (institucionet dhe procedurat; përfaqësimi dhe demokracia pjesëmarrëse; liritë demokratike) dhe *parimet demokratike* (përparësia e ligjit dhe e së drejtës, drejtësia shoqërore; barazia, pluralizmi; kohezioni shoqëror; përfshirja; mbrojtja e minoriteteve, solidariteti; paqja, stabiliteti dhe siguria);
- *qytetari* (fuqizimi dhe përgjegjësia; pjesëmarrje aktive);
- *shoqëria civile* (parimet, institucionet dhe procedurat e një shoqërie civile; fuqizimi i shoqërisë civile; marrëdhëniet me shtetin);
- *zhvillimi* (ndryshime të qëndrueshme).

Përdorimi si duhet i koncepteve dhe i vlerave njerëzore demokratike varet shumë nga zhvillimi i aftësive qytetare të tilla si:

- *të menduarit kritik*: aftësia për të kërkuar, për të analizuar dhe për të zgjedhur informacione, duke shfrytëzuar njohuritë ndërlëndore, shprehitë e shumëfishta dhe qëndrimin kritik; aftësia për të marrë vendime mbi bazën e të dhënave dhe për të ndryshuar qëndrimet si rrjedhojë e argumenteve të vlefshme;
- *të menduarit krijues*: aftësia për të zbuluar mënyra të reja dhe të pazakonta për të grupuar faktet në kuadrin e një procesi vendimmarrjeje, që shmang në maksimum përgjithësimet e tepruara, paragjykimet dhe stereotipat;
- *të menduarit drejt sjelljeve shoqërore dhe shoqërisë*: aftësia për të analizuar faktet dhe problemet dhe për të bërë zgjedhje në interes të nevojave të të tjerëve dhe të shoqërisë në tërësi, duke luftuar egocentrizmin dhe etnocentrizmin; aftësia për të komunikuar me të tjerët dhe për të mësuar nga përvojat e ndryshme;
- *të menduarit e drejtuar nga e ardhmja*: aftësia për të identifikuar dhe kuptuar problemet dhe për të vlerësuar vendimet në dritën e përvojave, me qëllim që e ardhmja e synuar të jetë më e drejtë.

Përveç të kuptuarit të koncepteve dhe të vlerave themelore dhe fitimit të aftësive themelore për një pjesëmarrje aktive dhe të përgjegjshme, për qytetarin janë të nevojshme edhe një tërësi qëndrimesh aktive shoqërore, të përcaktuara përgjithësisht në kuadrin e pjesëmarrjes dhe të përkushtimit ndaj vlerave të njohura e të pranuar si universale në shoqëri, si:

- përkushtimi ndaj parimit të universalitetit, të ndërvarësisë dhe të pandashmërisë së të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore;
- bindja për vlerën, dinjitetin dhe lirinë e individit;
- përkushtimi ndaj shtetit të së drejtës, drejtësisë, barazisë dhe paanësisë;
- përkushtimi ndaj paqes dhe zgjidhjes pjesëmarrëse, paqësore dhe konstruktive të problemeve shoqërore;
- bindja për vlerën dhe domosdoshmërinë e parimeve, institucioneve dhe procedurave demokratike, si dhe për rëndësinë e veprimit qytetar;

- respektimi i kulturave të tjera dhe i ndihmesës së tyre për njerëzimin; pranimi i parimit të pluralizmit në jetën e përditshme;
- përkushtimi ndaj vlerës së mirëkuptimit të ndërsjellë, të bashkëpunimit, të mirëbesimit dhe të solidaritetit, si dhe ndaj luftës kundër racizmit, paragjyqimeve dhe çdo forme të diskriminimit;
- bindja në rëndësinë e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë personale;
- përkushtimi ndaj parimit të zhvillimit njerëzor të qëndrueshëm, që mban parasysh ekuilibrin ndërmjet zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe mjedisor.

### **Çfarë kërkohet nga mësuesi i lëndës së edukimit qytetar?**

Rolet dhe kompetencat që mësuesit dhe nxënësit kanë pasur tradicionalisht, sot kanë pësuar ndryshime. Disa nga ndryshimet që kanë ndodhur në kompetencat tradicionale të mësuesve lidhen me:

- *dijet e integruara ndërlëndore përkundrejt dijeve të kufizuara në kuadrin e lëndëve të veçanta* në: lëndët mësimore; teoritë dhe çështjet që lidhen me natyrën dhe zhvillimin njerëzor; përshtatjen e teorive të ndryshme të të mësuarit për arritjen e synimeve të veçanta edukative; (në fushën e sjelljes, të njohurive dhe të humanizmit); parimet e procesit të mësimdhënies/ të të nxënësve; organizimin dhe administrimin e veprimtarive në grup;
- *procesin e shumëfishtë dhe dinamik të mësimdhënies përkundrejt procesit linear dhe statik të saj*, në të gjitha përmasat e tij: a) në përpunimin dhe përcaktimin e objektivave të larmishëm; b) në administrimin elastik të orëve të mësimit dhe të grupeve; c) në shumëllojshmërinë e modeleve të mësimdhënies përmes të mësuarit të hapur dhe në bashkëpunim; d) në vlerësimin e ndërsjellë;
- *synimet edukative të shumëfishta përkundrejt atyre të kufizuara në fushën e njohurive. Të parat* marrin parasysh kompleksitetin e botës së sotme dhe ndryshimet që ndodhin në të. Ato mbështeten në angazhimin individual për të përmirësuar kushtet e jetës dhe për të zotëruar shprehitë e nevojshme për veprim.

Një prej kërkesave më të rëndësishme në fushën e mësimdhënies është bindja e mësuesit në aftësinë e nxënësve për të mësuar dhe që ai vetë është i aftë t'i mësojë ose t'i ndihmojë për të mësuar. Të mësuarit për qytetarinë demokratike përfshin edhe aftësi të tjera të mësimdhënies që janë të rëndësishme për procesin e aftësimit të nxënësve për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm:

- aftësia për t'i parë problemet nga këndvështrimi i nxënësit, duke marrë parasysh prejardhjen, moshën dhe nivelin e tij arsimor, si dhe aftësia për të mos paragjykuar qëndrimet dhe perceptimet që janë të ndryshme nga të tija;
- aftësia për të kuptuar, pranuar dhe respektuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet mësuesve dhe nxënësve si dhe ndërmjet nxënësve;
- respektimi i të drejtave të nxënësve dhe ndjeshmëria ndaj nevojave dhe interesave të tyre;
- aftësia për të trajtuar çështje të diskutueshme dhe për t'u përballuar me situata problematike dhe komplekse që mund të ndeshen në mjedisin shkollor;
- aftësia për ta parë veten dhe nxënësin si pjesëmarrës aktiv në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- bindja në mundësinë e progresit dhe që çdo individ mund të ndihmojë në arritjen e tij;
- aftësia për të integruar përparësitë vetjake në një kuadër të përbashkët problemesh e vlerash dhe për të zbatuar në praktikë vendimet e marra nga nxënësi;

- gatishmëria për të pranuar gabimet para grupit dhe për të nxjerrë mësim prej tyre;
- aftësia për të shtruar dhe debatuar haptazi për probleme të diktuar nga kurrikula e fshehtë.

## 1. PROGRAMI I LENDES EDUKATE QYTETARE KLASA V

Lënda Edukatë qytetare e klasës së pestë është pjesë zyrtare e kurrikulës së arsimit fillor, e cila është e ndërtuar mbi parimet e njohura kurrikulare të vazhdimësisë, të integritit dhe të vargëzimit, që nënkuptojnë rimarrjen e herëpashershme të njohurive të trajtuara më parë.

Kjo lëndë në këtë klasë do të jetë në 35 javë mësimore dhe do të zhvillohet një orë në javë si më poshtë:

<b>35 javë x 1 orë:</b>	<b>35 orë</b>
<b>Kurrikula zyrtare:</b>	<b>27 orë</b>
<b>Kurrikula e lirë në dispozicion të mësuesit</b>	<b>8 orë</b>

## 2. SYNIMI I LËNDËS

Përmbajtja e programit të klasës së pestë vazhdon të thellojë dhe të plotësojë në rrjedhën e saj synimet e parashtruara që në fillimet e kësaj lënde, në klasën e parë të këtij cikli shkollimi. Kjo lëndë synon:

- *Të mundësojë tek fëmijët të mësuarit e njohurive të shoqërizimit dhe të qytetarisë, duke zhvilluar aftësi intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, për të analizuar dhe për të zbatuar në praktikë idetë, detyrat dhe përgjegjësitë që u takojnë në mjedisin shoqëror ku jetojnë.*
- *Të zhvillojë tek kjo moshë aftësitë e pjesëmarrjes qytetare dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme në zgjidhjen e problemeve të komunitetit ku bëjnë pjesë.*
- *Të zhvillojë tek ata përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave dhe të parimeve demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.*

## 3-LINJAT DHE NËNLINJAT E PËRMBAJTJES

Programi i klasës së pestë të arsimit fillor në mënyrë të tërthortë prek të gjitha linjat e standardeve të përmbajtjes, të tilla si:

1. Kultura
2. Koha, vazhdimësia, ndryshimi
3. Njerëz, vende, mjedise
4. Zhvillimi individual dhe identiteti
5. Individët, grupet dhe institucionet
6. Pushteti, autoriteti, qeverisja
7. Prodhimi, shpërndarja, konsumi
8. Shkenca teknologjia, shoqëria
9. Lidhjet globale
10. Idealet dhe praktikrat e shoqërisë

Të gjitha këto linja të përmbajtjes janë marrë dhe rimarrë më parë në klasat I-IV, diku më shumë ose më pak, por në klasën e pestë, në mënyrë të posaçme, është menduar prekja e disa prej sipas tabelës së mëposhtme.

#### 4. OBJEKTIVAT DHE KONCEPTET KRYESORE SIPAS FUSHAVE DHE NËNFUSHAVE TE PERMBAJTJES

Fushat	Objektivat	Konceptet dhe aftësitë kryesore	Numri i orëve sipas linjave
<b>Zhvillimi individual dhe identiteti</b>	<p><b>Familja</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të përshkruajë si ka ndryshuar historikisht familja.</li> <li>▪ Të përshkruajë funksionet që kryen familja dhe të diskutojë konkretisht rreth tyre;</li> <li>▪ Të japë shembuj të mosmarrëveshjeve në familje si edhe mendime, propozime, e rrugëzgjdhje të reja si domosdoshmëri për mbarëvajtjen e familjes.</li> </ul>	<p>Familja</p> <p>Ndryshimi i familjes</p> <p>Funksion i familjes</p> <p>Mbarëvajtje e familjes</p> <p>Përgjegjësi familjare</p>	<b>4 orë</b>
<b>Njerëz, vende dhe mjedise</b>	<p><b>Komuniteti</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të tregojë ç'kupton me <i>grup shoqëror</i> dhe të emërtojë disa prej tyre.</li> <li>• Të vendosë sipas rëndësisë karakteristikat e grupit shoqëror.</li> <li>• Të përshkruajë grupet ku bën pjesë dhe të përshkruajë rolet që luan ai gjatë ditës.</li> <li>• Të analizojë rolin e udhëheqësit të grupit duke përcaktuar cilësitë që duhet të ketë ai.</li> <li>• Të marrë pjesë për zgjedhjen e udhëheqësit të grupit ose klasës, duke i kushtuar rëndësinë procedurës së zgjedhjeve dhe të votimit</li> <li>• Të demonstrojë aftësi në lojën me grupe, në rolin e anëtarit të thjeshtë si dhe të udhëheqësit.</li> <li>• Të sqarojë kuptimin e vetëpërmbytjes.</li> <li>• Të argumentojë me shembuj konkretë nga jeta e tyre e përditshme në shkollë e në komunitetin ku banon pasojat pozitive dhe negative të vetëpërmbytjes.</li> <li>• Të demonstrojnë vlera të tilla si e vetëpërmbytja e kompromisi në grupet ku bën pjesë.</li> <li>• Të sqarojë kuptimin e fjalës <i>komunitet</i>, të dallojë llojet e komuniteteve dhe të përcaktojë nga se ndryshojnë ato nga njeri tjetri.</li> <li>• Të përshkruajë aspekte të ndikimit të komunitetit tek njerëzit si p.sh. për të mësuar për ta bërë jetën më të gëzueshme, për një komunikim më të mirë etj.</li> <li>• Të përshkruajë se çdo të thotë të jesh qytetar i mirë në familje, në shkollë e në komunitet.</li> <li>• Të vlerësojë punën e qytetarëve për përmirësimin e jetesës në komunitet.</li> </ul>	<p>Grup shoqëror</p> <p>Karakteristika të grupit</p> <p>Anëtar grupi</p> <p>Drejtues grupi</p> <p>Procedurë zgjedhjeje</p> <p>Votim</p> <p>Aftësitë për të pranuar dhe për të punuar në grup</p> <p>Kompromis dhe aftësia për kompromis</p> <p>Vetëpërmbytje</p> <p>Aftësi për vetëpërmbytje</p>	<b>10 orë</b>
<b>Individët,</b>			

<b>grupet dhe institucionet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të tregojë se ç'kupton me <i>grup vullnetar</i>, t'a dallojë atë nga grupi shoqëror duke e ilustruar me shembuj.</li> <li>• Të rradhisë grupet vullnetare që njeh, të përshkruajë një grup vullnetar në të cilin bën pjesë vetë ose shokët e tij dhe të flasë për rëndësinë që ka ai për komunitetin.</li> <li>• Të dallojë dhe të përshkruajë disa nga punët vullnetare që fëmijët dhe të rriturit mund të bëjnë për ta bërë jetën në komunitet më të mirë</li> <li>• Të diskutojë për rolin e një qytetari të arsimuar në përparmin e komunitetit dhe të shoqërisë në përgjithësi.</li> </ul>	<p>Qytetar i mirë</p> <p>Komunitet</p> <p>Jetë në komunitet</p> <p>Punë vullnetare</p> <p>Grup vullnetar</p>	
<b>Pushteti, autoriteti, qeverisja</b>	<p><b>Qeverisja</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përshkruajë organizimin e pushtetit vendor në komunë, bashki e prefekturë.</li> <li>• Të përshkruajë mënyrën se si organet e qeverisjes vendore zgjidhen nga komuniteti dhe, në të njëjten kohë, përgjigjen para tij.</li> <li>• Të krahasojë procedurën e zgjedhjeve në klasën e tij me atë që përdoret për zgjedhjen e qeverisjes lokale.</li> <li>▪ Të diskutojë për rëndësinë e procedurës së zgjedhjeve dhe për dhënien llogari të njerëzve të zgjedhur para zgjedhësve.</li> </ul>	<p>Organizim pushteti</p> <p>Pushtet vendor</p> <p>Organe vendore</p> <p>Komunë</p> <p>Bashki</p> <p>Prefekturë</p> <p>Zgjedhje vendore</p> <p>Dhënie llogari</p>	<p><b>4 orë</b></p>
	<p><b>Edukim rrugor</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të dallojnë tiparet kryesore të llojeve të ndryshme të automjeteve dhe të shqyrtojnë rreziqet që paraqesin për këmbësorët “pikat e verbëra”;</li> <li>▪ Të diskutojnë për rreziqet që paraqet kalimi prapa ose ndërmjet makinave të parkuara dhe të praktikojnë situata konkrete;</li> <li>▪ Të analizojnë konfliktet që lindin ndërmjet përdoruesve të ndryshëm të rrugës, për shembull ndërmjet çiklistëve dhe këmbësorëve në një vend për këmbësorë;</li> <li>▪ Të shpjegojë pasojat që kanë për vete dhe për të tjerët përdorimi prej tyre i kryqëzimeve dhe rrugëve të mbrojtura dhe të sigurta, duke vlerësuar pasojat e mundshme të moszbatimit të tyre;</li> <li>▪ Të diskutojë për ndikimin që ka sjellja e pasagjerëve për vete dhe për të tjerët (edhe për automjetet)</li> </ul>	<p>Automjete</p> <p>Lloje automjetesh</p> <p>Rrezik</p> <p>Pika të verbëra</p> <p>Kalim prapa</p> <p>Makinë e parkuar</p> <p>Përdorues rruge</p> <p>Kryqëzim</p> <p>Rrugë e sigurtë</p> <p>Rrugë e pasigurtë</p>	<p><b>4 orë</b></p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të japë përfundimet e tij nga informacionet që merr për rrugët dhe ngjarjet që ndodhin ne to:</li> </ul>	Këmbësor Rrugë për këmbësorë Pasagjer	
<b>Prodhimi, shpërndarja, konsumi</b>	<p><b>Edukim ekonomik</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të zhvillojë një plan të vogël biznesi për prodhimin e një produkti që konsumohet prej tyre. Për këtë ai duhet:</li> <li>• Të dallojë disa nga produktet ushqimore që përdoren më shumë nga fëmijët, për shembull, hamburger, patatina etj. dhe të zgjedhë njërin prej tyre për shembull, hamburgerin           <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të dallojë <b>burimet</b> e nevojshme për prodhimin e tij               <ul style="list-style-type: none"> <li>– Lokali (qeraja e lokalit )</li> <li>– Lënda e parë (buka, mish, salca, patatja, qeset mbështjellëse etj)</li> <li>– Fuqia punëtore (sa veta do të marrin pjesë për prodhimin e tij)</li> </ul> </li> <li>• Të dallojë <b>llojet</b> e punës për prodhimin e hamburgerit, si për shembull:               <ul style="list-style-type: none"> <li>– Organizimi i punës</li> <li>– Furnizimi i lëndës së parë</li> <li>– Pastruesi dhe përgatitësi i lëndës së parë</li> <li>– Gatimi (i salcës, i mishit etj) etj.</li> </ul> </li> <li>• Të studiojë <b>vendin</b>, numrin e mundshëm të fëmijëve që mund të kalojnë dhe të blejnë hamburger në atë vend</li> <li>• Të llogarisë cilat <b>shpenzime</b> tipike bëhen për të prodhuar një hamburger;</li> <li>• Të dallojë që kosto e një hamburgeri pakësohet sa më shumë hamburgera të prodhohen dhe të shiten.</li> <li>• Të llogarisë fitimin nga shitja:               <ul style="list-style-type: none"> <li>○ E një hamburgeri</li> <li>○ E dhjetë hamburgerave</li> <li>○ E njëzet hamburgerave</li> </ul> </li> </ul> </li> </ul>	Sipërmarrje  Ndërmarrja në veprim  Biznes  Plan biznesi  Produkt ushqimor  Konsum  Burim prodhimi  Lëndë e parë  Lloje pune  Organizim pune  Fuqim punëtore  Shpenzime  Kosto  Fitimi	<b>5 orë</b>



## 5. SHPËRNDARJA E SUGJERUAR E ORËVE

Tema	Numri i orëve
Familja	4 orë
Komuniteti	10 orë
Qeverisja	4 orë
Edukim rrugor	4 orë
Edukim ekonomik	5 orë
Gjithsej	27 orë
Kurrikula e lirë për mësuesin	8 orë

## 6. ZBATIMI I KURRIKULËS SË LIRË

Qëllimi i kurrikulës së lirë (15% e orëve totale) është t'i lërë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës dhe të mësuesit për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me objektivat e programit zyrtar të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe të përparësive arsimore që vendos mjedisi i veçantë në të cilin zhvillohet procesi i arsimimit

Statusi i tyre është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël. Është i detyrueshëm sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor. Është fleksibël sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është kompetencë e mësuesit të lëndës në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore, Drejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës.

Materiali mësimor që do të përgatitet dhe do të përzgjidhet nga mësuesi duhet t'i shërbejë realizimit të objektivave të programit dhe synimeve të prgjithshme të lëndës së edukimit qytetar e formave të tjera të edukimit që lidhen me të.

Grumbullimi i fakteve, i shifrave dhe i të dhënave të ndryshme historike, gjeografike, demografike, kulturore, industriale, bujqësore, mund të kthehen në një burim të vlefshëm për të organizuar orë mësimore interesante.

Organizimi i ekskursioneve në natyrë, të shoqëruara me veprimtari praktike; organizimi i vizitave në qendra të ndryshme prodhimi, të shoqëruara me vrojtme dhe me detyra në shërbim të realizimit të objektivave të caktuara të programit; organizimi i konkurseve dhe i lojërave të ndryshme zbavitëse që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive intelektuale dhe pjesëmarrëse dhe fuqizojnë të nxënësit dhe zhdërvjelltësojnë procesin e mësimdhënien, sugjerohen për t'u zhvilluar nga mësuesi në kuadrin e orëve që ai ka në dispozicion.

Për rritjen e efektshmërisë së kurrikulës së shkollës mund të bashkëpunohet edhe me mësuesit e lëndëve të tjera, duke programuar dhe zhvilluar veprimtari të përbashkëta që mundësojnë edhe realizimin e lidhjeve ndër-lëndore.

Shpërndarja dhe larmia e veprimtarive, duhet të bëhet duke analizuar me kujdes si programin ashtu edhe kërkesat që parashetrojnë veçoritë vendore.

Realizimi i sugjerimeve të mësipërme kërkon nga mësuesi jo vetëm aftësi krijuese, por edhe aftësinë e një hartuesi të vërtetë kurrikule, për rrjedhojë, edhe përgjegjësinë profesionale dhe qytetare që bart në vetvete ky rol.

## **7. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT**

Përmbajtja e lëndës së edukatës qytetare e klasës së pestë ofron mundësi të shumta që mësuesit të zhvillojnë orë mësimore bazuar në :

- ndërveprimin aktiv midis mësuesit dhe fëmijëve,
- shfrytëzimin e përvojave personale të fëmijëve
- pjesëmarrjen efektive të fëmijëve në veprimtaritë mësimore
- pavarësinë e fëmijëve në shprehjen e lirë të ideve dhe opinionëve vetjake
- përdorimin e mjeteve didaktike të domosdoshme për zhvillimin normal të programit.

Ky edukim arrihet nëpërmjet përdorimit të metodave, teknikave dhe strategjive ndërvepruese që krijojnë një bashkëpunim harmonik midis mësimeve dhe të nxëniet, ku ndërthuren lloje të ndryshme të edukimit, të tilla si: edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi ndërkulturor, edukimi për paqe, edukimi global, edukimit nëpërmjet medias, edukimi mjedisor, edukimi rrugor, edukimi ekonomik etj.

Programi kësaj lënde është element i një kurrikule të hapur të formimit qytetar dhe si e tillë ajo nuk i pranon lehtë format tradicionale të mësimeve dhe të të nxëniet, kur roli i mësuesit është thjesht transmetues i dijeve, kurse fëmija një dëgjues pasiv. Të kundërtën synon ky program. Ai motivon një ndërveprim të efektshëm midis fëmijëve dhe mësuesit, midis punës në grupe të vogla dhe të mëdha, midis punës së pavarur dhe asaj individuale, por përparësi duhet të marrë stimulimi i ideve të ndryshme, të shumta të dalta nga fëmijët, reflektimi kritik i tyre ndaj koncepteve të përmbajtjes lëndore. Një element i një rëndësie të veçantë konsiderohen produktet e veprimtarive që mund të përgatiten nga fëmijët në klasë, si postera, struktura të ndryshme mendore në letra të bardha, gazeta të ndryshme ose reflektime të shkruara për çështje të ndryshme. Produktiviteti i fëmijëve shihet si një tregues cilësor i zbatimit të këtij programi.

Pretendimet e kësaj lënde janë të mëdha. Përmbajtja e saj del jashtë kufinjve të orës mësimore, të strukturave tradicionale të shkollës. Ajo thyen “disiplinën” mësimore në klasat tona. Ajo kërkon debat, gjallëri, mbajtje qëndrimesh, opinionë të ndryshme, të shumta në pikëvështrime të shumëllojshme nga ana e fëmijëve, gjë që nuk është e lehtë, pasi kjo lidhet me formimin gjuhësor, shkencor dhe aftësitë personale të fëmijëve, të cilën ua mundësojnë edhe lëndë të tjera të kurrikulës së këtij cikli shkollimi. Në këtë kontekst edukata shoqërore ndërthur dhe integron natyrshëm shumë njohuri të fituara në lëndë të tjera.

Një aspekt tjetër i shtjellimit të kësaj lënde është përdorimi i përvojave personale, i ngjarjeve të ndryshme të komunitetit ku ata bëjnë pjesë, si raste studimi për shumë tema mësimore dhe objektiva që synon të pëmbushë kjo lëndë. Në këtë kuptim “rastet e studimit” nga komuniteti shërbejnë si ura lidhëse midis formimit të fëmijëve në shkollë dhe jetën reale që përballojnë, por efektiviteti i kësaj mënyre të vepruarit reflektohet natyrshëm në qëndrimet që fëmija do të mbajë konkretisht brenda grupit shoqëror, të cilit i përket.

Mësuesit përdorin dhe zhvillojnë në mësimeve të tyre modele të ndryshme të saj, por ky program kërkon së pari planifikimin dhe zhvillimin e mësimeve

ndërvepruese, që ka në themel bashkëveprimin mësues-fëmijë, mjedis fizik, materiale didaktike, personale të mësuesit dhe fëmijës, si dhe produkte të shumta të hartuara dhe përgatitura nga vetë fëmijët, ku puna në grupe është e rëndësishme, por e shoqëruar patjetër me punën e pavarur dhe atë individuale.

Linjat e standardeve të përmbajtjes të përfshira në këtë program, ndonëse paraqesin drejtime të përcaktuara krijojnë mundësi që shtjellimi i këtij programi të ndjekë rrjedhën e marrjes së njohurive dhe të rimarrjes hërë pas here të tyre. P.sh nëse tek linja “Kultura” trajtohen koncepte që lidhen me vendlindjen dhe kulturën që i përket fëmija, kjo është një mundësi e mirë për ta trajtuar këtë formim të fituar tek linja “lidhjet globale”, duke e përdorur si krahasim me kultura të tjera brenda dhe jashtë vendit, sipas objektivave të synuara. Në këtë kuptim mësuesit profesionistë do të mund të gjejnë mjaft pika lidhjeje midis linjave të standardeve të përmbajtjes, të cilat përbëjnë një bazë të mirë formimi të fëmijëve dhe që mund të përballojnë njohuritë që vijnë më pas.

Për një ecuri sa më normale të kësaj lënde mësuesit duhet të kenë parasysh dhe dy elementë të rëndësishëm kurrikularë të tillë si: mjedisi i klasës dhe mjetet didaktike më të domosdoshme për fëmijët.

## **Mjedisi**

Mjedisi nënkupton vendin ku do të zhvillohet edukata shoqërore. Zakonisht si mjedis në të tilla raste rëndom është klasa, por nuk përjashtohen dhe mundësira dhe përvoja, që të tilla veprimtari të zhvillohen dhe në mjedise të posaçme që shkolla i ka modeluar dhe i ka përgatitur enkas për edukimin qytetar të fëmijëve të saj. Gjithsesi me mjedis në këtë rast do të kuptojmë:

**Mjedisin fizik**, që duhet të jetë fleksibël dhe lehtësisht i menaxhueshëm. Ai duhet të krijojë mundësi që të gjithë pjesëmarrësit të lëvizin lirisht, të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin dhe të kenë mundësi në çdo çast të shikojnë lirisht njëri-tjetrin dhe mësuesin. Idetë dhe mendimet që shkruhen në fletët e mëdha të bardha ose të tjera që prezantohen me video, me kompjuter ose në fotoprojektor të jenë të dukshme dhe të qarta për të gjithë. E gjithë hapësira e mureve në të katër anët e klasës ose vendit të posaçëm për zhvillimin e veprimtarive duhet të jetë e shfrytëzueshme dhe e dukshme për të gjithë fëmijët

**Mjedisin psikologjik i cili** ka të bëjë me sigurinë dhe dëshirën që kanë fëmijët për të marrë pjesë në veprimtari mësimore. Krijimi i një klime psikologjike pozitive është domethënës në të tilla raste. Kjo mund të arrihet përmes përdorimit të veprimtarive të tilla si lojëra, të ushtrime të nxemjes, të situata dramatizuese dhe argëtuese të cilat janë mjaft të pëlqyeshme për fëmijët dhe i motivojnë ata për të marrë pjesë në të tilla veprimtari edukuese. Filozofia e mjedisit psikologjik është: “Të gjithë kemi se çfarë të themi, të gjithë mund të mësojmë nga njëri-tjetri”. Krijimi i një mjedisi të tillë kërkon një përgatitje serioze nga mësuesit, për të gjetur forma dhe situata që rrisin interesimin dhe motivimin e fëmijëve për t’u përfshirë në këtë edukim.

## **Mjetet**

Mjetet janë një element i domosdoshëm për zhvillimin e kësaj lënde. Në procesin e zhvillimit të kësaj lënde është mbajtur parasysh kriteri që mjetet të jenë sa më pak të kushtueshme dhe të përshtatshme për natyrën dhe punët që kryejnë fëmijët. Kështu, si

mjete më të domosdoshme për këtë lëndë, përveç tekstit të edukatës shoqërore, secili fëmijë duhet të ketë:

1. Lapsa me ngjyra (druri )
2. Gërshërë
3. Stilolaps
4. 1 Fletore shkrimi
5. Ngjitës
6. 1 Fletore me ngjyra
7. 1 Fletore vizatimi

## 8. LIDHJA NDËRLËNDORE

*Edukata shoqërore* duhet të zhvillohet në lidhje të ngushtë me lëndët e tjera. Lënda e *Edukatës shoqërore* dhe lëndët e tjera duhet të ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet edhe objektivat kryesorë të shkollës dhe të shoqërisë në fushën e arsimit.

Çfarë do të thotë kjo?

- Së pari, *Edukata shoqërore* mund të shfrytëzojë informacionin dhe çështjet që trajtohen në lëndët e tjera për të sqaruar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë idetë e veta.
- Së dyti, lëndët e tjera duhet të shfrytëzojnë përmasën dhe këndvështrimin e edukimit qytetar për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë

## Shembuj

### I. Historia dhe Edukata shoqërore

*Lënda e historisë dhe ajo e edukatës shoqërore kanë të përbashkët:*

- **Konceptet:** për shembull pushteti, autoriteti, ligji, qeverisja, përfaqësimi, liria, etj.
- **Aftësitë dhe shprehjet:** për shembull përshkrimi, analiza, shpjegimi, diskutimi, kërkimi, interpretimi etj

*Edukata shoqërore:*

- u jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret historia. Në këtë mënyrë, ai i ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e historisë për jetën e tyre të përditshme.

*Si mund të realizohet lidhja ndërmjet lëndës së historisë dhe Edukata shoqërore?*

1. Së pari kjo lidhje mund të realizohet përmes përfshirjes të çështjeve, të fakteve, të ngjarjeve etj. të trajtuar në lëndën e historisë në kurrikulën e *Edukatës shoqërore* me kusht që përmasa e qytetarisë duhet:

- Të jetë çështja thelbësore e mësimit;
- Të lidhet me kurrikulën e *edukatës shoqërore*;

2. Së dyti, objektivat mësimorë duhet të shprehen qartë dhe të jenë pjesë e kurrikulës kombëtare të *Edukatës shoqërore*. Kështu, lidhja ndërmjet tyre mund të realizohet përmes elementeve të mëposhtëm

- **Konceptet:** Karakteristikat e koncepteve (si drejtësia, barazia, liria etj) duhet të shpjegohen në kohë dhe në hapësirë, pra në kontekste konkrete historike, në të kaluarën dhe në të sotmen.
- **Tema:** Në disa mësimë mund të theksohet përmasa e qytetarisë, si për shembull, në çështjet e të drejtave të njeriut.
- **Fusha kurrikulare:** Rishqyrtimi i vazhdueshëm i çështjeve të tilla si demokracia etj., gjatë gjithë ciklit të shkollimit.
- **Përmasa vendore:** historia duhet të ndihmojë në rritjen e pjesëmarrjes qytetare në jetën e bashkësisë, për shembull, duke ndërmarrë projekte ku mund të përfshihen breza të ndryshëm.

3. Së treti, historia ndihmon në edukimin qytetar kur ajo përdoret në debatet për çështje dhe ngjarje të rëndësishme

## II. Gjeografia (Dituria e natyrës) dhe edukata shoqërore

1. *Çfarë kanë të përbashkët Gjeografia (Dituria e natyrës) dhe Edukata shoqërore? Ato kanë të përbashkët:*

- **Konceptet:** të drejtat e njeriut, bashkësia, ndërvarësia etj.,
- **Përmbajtjen:** bota si bashkësi globale, sfidat e ndërvarësisë globale etj,
- **Temat:** strehimi, komunikimi etj,

2. *Si mund të ndihmojë lënda e gjeografisë në trajtimin e çështjeve të lëndës së edukatës shoqërore:*

- Ndhmon nxënësit të kuptojnë më mirë ndikimin e veprimtarisë ekonomike tek njerëzit dhe te bashkësia ku jetojnë;
- Nxjerr në pah marrëdhëniet ndërmjet zhvillimeve vendore, kombëtare dhe globale;
- Nxjerr në pah mundësinë e qytetarëve për të ndikuar në jetën e bashkësisë dhe më gjerë;
- Shqyrton në gjerësi dhe në thellësi çështje të zhvillimit të qendrueshëm;
- Nxit respektin për njerëz dhe kultura të tjera si dhe për mjedisin.

3. *Në ç'mënyrë lënda e edukatës shoqërore ndihmon në zhvillimin e lëndës së gjeografisë? Edukata shoqërore:*

- Zbulon lidhjet e çështjeve me të cilat merret lënda e gjeografisë me jetën e përditshme të nxënësve dhe rrit interesin e tyre për to;
- Ndhmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e lëndës së gjeografisë;
- Nxit të kuptuarit e çështjeve që lidhen me zhvillimin, për shembull, tregtinë e ndershme;
- Nxit nxënësit të marrin pjesë në zhvillimin e projekteve të ndryshme në bashkësinë ku jetojnë, për shembull, për çështje mjedisore.

## 9. VLERËSIMI

### Parime të përgjithshme

Standardet e përmbajtjes së lëndës së **edukatës qytetare** përfshijnë tri elemente të ndërlidhur me njëri tjetrin: njohuritë, aftësitë intelektuale dhe ato të pjesëmarrjes dhe prirjet qytetare. Të marrë së bashku këta elementë përbëjnë bazën për zhvillimin e **edukatës qytetare** dhe për rrjedhojë edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve duhet të pasqyrojë nevojën për të vlerësua shkallën e përvetësimit të këtyre tri elementëve nga nxënësit.

**Njohuritë** përbëjnë thelbin e sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen, për shembull, në pyetje të tilla si:

- Cila është procedura e zgjedhjeve vendore?
- Cilat janë rregullat kryesore të kalimit në një kryqëzim?

**Aftësitë intelektuale dhe ato pjesëmarrëse** të edukimit qytetar përfshijnë përdorimin e njohurive për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese dhe për të vepruar në mënyrë të arsyeshme për të përballuar e zgjidhur sfidat e jetës demokratike në vend.

Aftësitë intelektuale aftësojnë nxënësit të mësojnë dhe të zbatojnë njohuritë qytetare në funksionet e shumta dhe të ndryshme të qytetarit. Këto aftësi i ndihmojnë qytetarët të identifikojnë, të përshkruajnë, të shpjegojnë dhe të analizojnë informacionin dhe argumentet si dhe të vlerësojnë, marrin dhe mbrojnë qëndrime të caktuar për çështje të jetës publike.

**Aftësitë pjesëmarrëse** aftësojnë qytetarët të monitorojnë dhe të ndikojnë jetën publike dhe atë qytetare duke bashkëpunuar me të tjerët, duke formuluar dhe shprehur qartë idetë dhe interesat e tyre, duke bërë koalicione, kërkuar konsensus, duke bërë marrëveshje dhe duke menaxhuar konfliktet.

Një vlerësim tërësor në lëndën e edukimit qytetar nënkupton edhe vlerësimin, në atë shkallë që kjo është e mundur, të aftësive pjesëmarrëse. Kjo do të thotë se testimi duhet të përfshijë edhe *matjen e shkallës në të cilën nxënësit kuptojnë përdorimin e duhur të aftësive pjesëmarrëse*. Këtu duhet të sqarohet se në këtë vlerësim nuk përfshihet matja e drejtpërdrejtë e aftësive pjesëmarrëse të nxënësve, për shembull, në qeverinë e nxënësve në shkollë ose në veprimtari të tjera publike.

Elementi i tretë janë **prirjet qytetare** të cilat përshkruajnë të gjitha aspektet e qytetarisë. Në një sistem demokratik ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe me përgjegjësitë e individëve në shoqëri dhe me çuarjen përpara të idealeve të qeverisjes demokratike.

Këtu përfshihen prirjet:

- për të qenë një anëtar i pavarur i shoqërisë,
- për të respektuar vlerat individuale dhe dinjitetin njerëzor,
- për të marrë përsipër përgjegjësitë personale, politike dhe ekonomike të qytetarit,
- për t'iu bindur “rregullave të lojës”, si pranimi i vendimit të ligjshëm të shumicës dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve,

- për të marrë pjesë në çështjet qytetare në mënyrë të mirinformuar, të arsyeshme dhe të efektshme
- për të nxitur dhe mbështetur funksionimin e shëndetshëm të demokracisë në vend.

Vlerësimi i prirjeve qytetare të nxënësve duhet të përqendrohet në pyetje që kanë të bëjnë me njohjen e rëndësisë që kanë këto prirje për demokracinë. **Vlerësimi në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshijë pyetje që kanë të bëjnë me vlerat dhe prirjet personale të nxënësve të vlerësuar.**

Për këtë arsye, pyetjet që lidhen me prirjet qytetare duhet të lidhen me njohuritë dhe aftësitë intelektuale. Për shembull, nxënësit mund t'u kërkohej të përshkruajnë rëndësinë e dëgjimit me respekt të mendimeve dhe opinioneve të tjerëve. *Po kështu, nxënësve mund t'u matet aftësia për të vëzhguar dhe zbuluar shkallën e përputhjes së veprimtarisë së qeveritarëve ose institucioneve qeverisëse me parimet kushtetuese.*

Fitimi i njohurive, i aftësive dhe zhvillimi i prirjeve qytetare realizohen në kontekste të ndryshme si shtëpi, shkollë, bashkësi, shtet, rajon e më gjerë. Të gjitha këto përbëjnë edhe fushat kryesore në të cilat jo vetëm fitohen njohuritë dhe aftësitë por edhe zbatohen ato në praktikë.

### **Vlerësimi në lëndën e edukatës qytetare në shkollë**

**Vlerësimi në lëndën e edukatës shoqërore** vlerësohet si një shtysë dhe motivim i pandërprerë i fëmijëve për të përballuar kërkesat e kësaj lënde. Ai nuk duhet parë thjesht në këndvështrimin e arritjeve të fëmijëve, por si një mekanizëm nxitës për pjesëmarrje me dëshirë në formimin qytetar.

Është e natyrshme që vlerësimi semestral ose përfundimtar i fëmijëve të kësaj klase do të bazohet në Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar me anë të sistemit të notave, por në këtë rast sugjerojmë që vlerësimi në veprimtaritë e edukimit qytetar të jetë një proces i gjatë, nxitës, dashamirës, të krijojë besim se fëmija është i aftë të ndryshojë dhe të bëjë diçka në këtë rrjedhë.

Si vlerësime nxitëse për fëmijët mund të shërbejnë:

- *Lavdërimi i produkteve* që bëjnë fëmijët ose të ngjarjeve që ata tregojnë për përvojat e tyre të jetuarit në shtëpi, në shoqëri, në klasë, mënyrat se si kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë qytetare në mënyrë të vazhdueshme.
- *Nxitja e fëmijëve-pjesëmarrës* në punën në grupe, duke përmendur rolet që ata kryejnë.
- *Krijimi në klasë* i një këndi ekspozues për punët e fëmijëve, i cili të ndryshojë herë pas herë për t'u dhënë mundësi të gjithë fëmijëve që të pasqyrojnë punën e tyre.
- *Përgatitja e dosjes personale* për secilin fëmijë, në të cilën të ruhen dhe të mbahen punët që ata kryejnë. Të gjitha materialet që do të mbahen u sugjerojmë mëuesve që të mos bëjnë vlerësime ose të shkruajnë mbi to shprehje vlerësuese. Renditja e produkteve që nga fillimi i vitit deri në fund u jep mundësi prindërve, mësuesve, pse jo dhe vetë fëmijës të shohë progresin që ai ka bërë nga fillimi e deri në fund të vitit mësimor.
- *Vlerësimi* që shkruhet në regjistër, sugjerohet që të jetë maksimal për të gjithë fëmijët.